



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 170, datë 25 05.2021

**PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT TË KËSHILLTARIT TË ETIKËS, PRANË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË ME KOHË TË PJESSHME**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 166 pika 2, 184, 182 pika 2 dhe 3, 189 pika 1, germa "b", të Ligjit 115 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, nenet 14 pika 2, 26 pika 1 germa c) dhe pika 2, si dhe nenin 47 pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Këshilltarit për Etikën me kohë të pjesshme.
2. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Këshilltari për Etikën përfiton një trajtim financiar 5% shtesë page, mbi pagën bruto fillestare të tij.
4. Ulja e ngarkesë do bëhet në përputhje me nevojat e punës, me qëllim garantimin e funksionimit të prokurorisë përkatëse.
5. Shprehja e interesit duhet të paraqitet jo më vonë se 2 javë nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Ana Komnena", Godina "Poli i Drejtësisë", Tiranë.**
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

